

## **SHKRIMI KRITIK**

# TAT TANUSHI si KONTI DRAKULA

*(Botuar në "Kohën Ditore" më 24 tetor 2009)*

**Shkruan: Zana Buçinca**

## Hyrje

Një vepër e Mitrush Kutelit, e cila ka zgjuar interes të madh tek studiuesit shqiptarë është "E madhe është gjëma e mëkatit", apo gjithashtu e njohur edhe si "Tat Tanushi i Bubutimës". Arsyeja e interesit, të studiuesve është shumë e qartë, pasi që Kuteli, që në fillim të veprës thotë se novela është e bazuar në dy legjenda të Pogradecit. Por, a është e bazuar novela me të vërtetë në ato legjenda? Apo, kjo ishte thjesht një tentativë e suksesshme e Kutelit për të mbuluar gjurmët e kërkimit të studiuesve? Apo, intertekstualiteti këtu është vetëm një "rastësi e pamundur"?

## Analiza teorike e veprës

Fillimisht, le të analizojmë veprën e Kutelit:

Për nga ana kompozicionale, vepra "E madhe është gjëma e mëkatit" është novelë. Bubutima, fshat në Ilirinë e lashtë, është topoja e kësaj novele. Narratori këtu ka rolin e narratorit të gjithëdijshëm dhe rrëfen për një prift Ilir, i cili është verbuar nga dashuria për gruan e tij dhe e ka harruar vetë Krijuesin e tij. Motivi bëhet i qartë që në titullin e veprës, pra "E madhe është gjëma e mëkatit". Titulli i veprës është mjaft tërheqës, pasi që e lë lexuesin në mëdyshje rreth përmbajtjes së librit dhe zgjon interes tek ai për leximin e mëtejshëm. E tërë vepra është shtjellim i titullit. Shtjellim, i cili bëhet me anë të veprimeve të Tatës, si personazh kryesor, si dhe protagonistëve të tjerë si: Noemi (Kalija) gruaja e Tatës, Imzot Nikanori etj., dhe antagonistëve që në këtë rast është gruaja, që e shtyn Tatën drejt mëkatit.

Narratori, duke rrëfyer veprimet e Tatës si prift, citon shumë pjesë biblike, të cilat e shtojnë diskursin biblik në numrin e diskurseve tjera që përdoren në vepër. Diskursi teologjik, gjithashtu ka përdorim, kur veprimet e Tatës i analizon Imzot Nikanori. Jeta shekullore e Tatës, krahas shndërrimit të kohës në kohë subjektive, gjithashtu e fut në vepër edhe diskursin fantastik. Mitet e ndryshme, të përmendura në novelë e formëzojnë edhe diskursin mitik. Pra, diskurse të ndryshme që janë të përdorura sa në rrëfimin e narratorit të gjithëdijshëm, ashtu edhe në dialogët e shumta në mes të personazheve. Dialogë, të cilët e bëjnë më të gjallë rrëfimin në mendjen tonë. Krahasimi, alegoria, antiteza dhe shumë figura të tjera stilistike mundësojnë që bëmat e Tatës ta impresionojnë lexuesin. Ideja kryesore e veprës është mëshira e Zotit për Tatën (robin e tij), të cilit i kishte dhënë jetë shekullore për t'u penduar për mëkatin e kryer. Ndërsa mesazhet janë të shumta, si: nuk duhet të hutohemi në jetën kalimtare dhe dashuria për Zotin duhet të jetë dashuria më e madhe që kemi në jetë, e shumë mesazhe të tjera.

## Çështje fabulare të veprës

Por, për të vërejtur ndonjë intertekstualitet, të mundshëm duhet ta analizojmë edhe fabulën e veprës.

Tata, që fillimisht ishte një ndjekës i rrugës së Zotit, shndërrohet në një jobesimtar që mban veshur rrobat e priftit, pas vdekjes së gruas së tij. Kalija (gruaja e Tatës) ishte judenje dhe Tata kishte rënë në dashuri me të. Dashuria, sa vinte e rritej dhe kështu Tata harroi dashurinë e Zotit. Me vdekjen e Kalijes, Tata filloi të bënte statuja druri të saj, gjë që binte ndesh me fenë të cilën e predikonte, ai vetë në kishë. Dhe kështu, derisa tërheqja e Tatës drejt mëkatit u bë e pa rezistueshme. Një grua që kishte ardhur, t'i blinte ca statuja të priftit ilir u bë shkas që Tata të rronte shekuj të tërë. Pa u pastruar nga mëkati, ai deshi të predikonte dhe ky ishte çasti, kur Zoti e mallkoi që të mos vdiste kurrë. Kaluan shekuj e shekuj, derisa dashuria e Zotit në zemrën e Tatës zotëroi mbi atë që ky kishte për gruan e tij. Pendimi, i singertë i priftit në rrënojat e kishës së mallkuar, ishte ai që e bëri Zotin ta thyente mallkimin dhe ta pranonte Tatën në botën e të vdekshmëve.

## Shtigjet e Kutelit drejt intertekstualitetit

Po, me të vërtetë Kuteli kishte humbur gjurmët për burimin e novelës së tij. Legjendat e Pogradecit, bibla janë detaje që studiuesit i kanë shtyrë drejt një studimi tërësisht të gabuar, të folklorit shqiptar e të librave fetarë, sepse askujt nuk iu kujtua ta krahasonte Tat Tanushin me vetë Kontin Drakula.

Mitrush Kuteli studioi në Rumani. Si mbledhës i folklorit shqiptar, ai u interesua edhe për folklorin rumun. Dhe, pikërisht atje u takua me figurën e Vllad Drakulës. Vllad Tepes (i njohur si Vllad Drakula), është personaliteti më i njohur dhe karakterizues i folklorit rumun. Versionet e legjendës së Drakulës janë nga më të ndryshmet, por diçka që dihet sigurt është se Vllad Drakula ishte besimtar dhe gruan e tij, Elizabetën e donte më shumë se jetën. Në Rumani, Vllad Tepes njihet si njëri ndër heronjtë e kombit, pasi që ishte gjithmonë i pranishëm në luftërat rumuno-osmane. Kështu, një herë u kthye në shtëpi nga lufta dhe gjeti gruan e tij të dashur të vdekur. Gruaja e Drakulës ia kishte marrë vetes jetën, pasi që kishte dëgjuar se i shoqi ishte vrarë nga turqit. Për Drakulën, ky ishte çasti kur mallkoi Zotin, Atë të cilin ia kishte marrë gjënë më të dashur në jetë, atë, pa të cilën jeta e tij nuk kishte kuptim. Drakula u shndërrua në vetë “djallin”. Filloi të pinte gjakun e grave të cilat i ngjasonin me të shoqen dhe kështu u shndërrua në një vampir. Dihet se Drakula jetoi me shekuj, pasi që pirja e gjakut të njerëzve e kishte bërë të pavdekshëm. Por, fundi i Drakulës është ende mister dhe ndryshon në versione të ndryshme, njëri prej të cilëve është romani, i cili i dha Drakulës përmasa botërore, romani “Drakula” i Bram Stokerit.

## Drakula dhe Tat Tanushi (Drakula në kornizë ilire)

Ç’rastësi! Drakula dhe Tata, të dy besimtarë krishterë, që luftojnë në rrugë të Zotit, njëri me shpatë ndërsa tjetri me fjalë. Tata e adhuronte Kalijen, të cilën e kishte sjellë vetë në Iliri. Në anën tjetër, Drakula e dashuronte marrëzisht Elizabetën, që po ashtu e kishte sjellë nga Hungaria në Rumani. Të dy, ia kthejnë shpinën Zotit me vdekjen e më të dashurave të tyre. Ndërsa, Zoti i mallkon të dy me pavdekësi. Shekuj të tërë jetojë si Tata, ashtu edhe Drakula. Tata, për të kujtuar sado pak Noemin zhytet thellë në mëkat. Po ashtu, edhe Drakula pi gjakun e grave që i ngjasojnë me Elizabetën, duke kryer gjithashtu mëkat. Dhe, në fund vdekja e dy të pavdekshmëve bëhet kur lirohen nga mallkimi, duke u bërë pluhur e hi, si Tata ashtu edhe Drakula. Bubutima e Bukovina! Ç’emra të ngjashëm të vendeve të këtyre dy figurave, për të qenë të rastësishëm!

Këto janë disa nga faktet, që dëshmojnë intertekstualitetin e këtyre dy veprave. Intertekstualitet, ky shumë i madh për të qenë i rastësishëm, për një autor i cili ka studiuar folklorin rumun dhe di shumëçka mbi Kontin Drakula, karakteristika të cilat janë të pranishme “rastësisht” edhe në vetë personazhin kryesor të novelës së tij.



## “Harry Potter” si “Mbreti i unazave”

*(Botuar në gazetën “Kosova Sot”, 20 dhjetor 2009 dhe revistën “Nacional”- Shqipëri, 14 shkurt 2010)*

**Shkruan: Zana Buçinca**

*Vepra shumëvëllimshme “Harry Potter”, nuk është asgjë tjetër, veçse një reflektim i zbehtë i veprës madhështore “The Lord of the Rings”, për të mos thënë “një mbindërtim i egër”; një huazim i pamëshirshëm tematik dhe tekstual*



## “Harry Potter” roman epik

Seria e librave “Harry Potter” ka thyer kufijtë e rekordeve të shitjes, duke hyrë në listën e librave më të lexuar të të gjitha kohërave, gjithsej i shitur në 44 milion kopje. Fillimisht, në qershor të vitit 1997 u botua libri i parë i kësaj serie “Harry Potter dhe Guri Filozofal”, e pas tij edhe 6 librat pasues, deri tek libri i shtatë dhe i fundit “Harry Potter dhe Dhuratat e Vdekjes”, i cili u botua në korrik të vitit 2007.

Rrëfimi për djaloshin jetim, Harry, është thurur në shtatë romane, të cilat e përbëjnë serinë e librave “Harry Potter”. Për nga forma kompozicionale, “Harry Potter” është roman epik, i ndarë në kapituj. Narratori në këtë roman pozicionohet si narrator i gjithëdijshëm duke rrëfyer kryesisht për bëmat e Harryt. Protagonistët kryesorë të ngjarjes janë: Harry, Roni, Herimiona, Urtimori, e shumë të tjerë. Ndërsa, antagonistët janë po ashtu të shumtë duke filluar me Lordin Fluronvdekje, Hamortët, Drakon-in e të tjerë. Pitoni, që deri në librin e fundit mendohet të jetë antagonist në fund kuptohet se ishte njëri ndër protagonistët kryesorë që mundësuan shuarjen e Fluronvdekjes. Fshehtësi të tilla, të shumta që janë të pranishme në secilin prej librave të “Harry Potter”-it, bëjnë të pamundur që libri të mos lexohet me një frymë, gjithashtu të shpërfaqet diskursi mistik. Dialogët në mes të personazheve janë të shumtë dhe përbëjnë pjesën më të madhe të romanit, i cili ka më shumë karakter rrëfyes sesa përshkrues. Vendi në të cilin zhvillohet e tërë kjo ‘dramë’ është Anglia. Ndërsa, koha është kryesisht objektive, por kur hyn në lojë Kohëkthyesi i Hermionës, atëherë ajo shndërrohet në kohë subjektive.

Gjithçka në këtë vepër ka të bëjë me fantastiken, gjë që e mundëson përdorimin e diskursit fantastik dhe atë mitik.

Alegoria, e përdorur më së shumti në fjalët e Urtimorit dhe figura të ndryshme stilistike sfidojnë lexuesin, të cilin e bëjnë të reflektojë rreth zgjidhjes së misterit, i cili në fund zgjidhet në mënyrë krejtësisht ndryshe nga hipotezat tona.

Mesazhet që mund të nxirren nga vepra janë të shumta dhe ndryshojnë nga secili vëllim, por mesazhi i cili përcillet që nga “Harry Potter” dhe Guri Filozofal deri tek “Harry Potter dhe Dhuratat e Vdekjes” është: Dashuria gjithmonë ngadhënjën mbi të keqen dhe urrejtjen.

Si fabul vepra bën fjalë mbi jetimin “Harry Potter”. Harryt i kishin vdekur prindërit dhe ishte rritur nga xhaxhai dhe teza e tij. Në ditëlindjen e 11 Harry kupton se ishte magjistar. Kështu shkon në Hoguorts, shkollë e magjisë. Secili nga librat e serisë paraqet një vit të Harryt në Hoguorts. Por, në secilin libër para tij shfaqen sfida të reja për shkatërrimin e magjistarit më të fuqishëm dhe më të tmerrshëm të të gjitha kohërave, Lordit Fluronvdekje, qëllim të cilin e arrin në librin e fundit.

## **“The Lord of the Rings” burim i intertekstualitetit**

Por, a është e mundur që autorja e librave “Harry Potter”, librave më të famshëm për fëmijë, J.K.Rowling të ketë “huazuar” elemente nga një tjetër libër bestseller?

Ngjashmëria në mes “Harry Potter” dhe “The Lord of the Rings” është tejet e hetueshme. “The Lord of the Rings” i J.R.R.Tolkien, i botuar në vitin 1954 është, po ashtu njëri ndër librat që ka arritur majat e lexueshmërisë, me 150 milion kopje të shitura. Përkundër faktit se është shkruar gjysmë shekulli më parë, “The Lord of the Rings” vazhdon të jetë libri i cili kryeson në listën e librave imagjnativ të letërsisë për të rritur. Pafundësia e imagjnatës së autorit të këtij libri është burim i pashtershëm, nga i cili çdo autor i veprave të tilla shuan etjen e tij.

Sikur ta krahasojmë “Harry Potter”-in me “The Lord of the Rings” do të vijmë në përfundim se J.K.Rowling jo vetëm se “ka shuar etjen”, por më shumë se kaq në “burimin e imagjnatës” së autorit të madh J.R.R.Tolkien e ka shfrytëzuar skajshmërisht.

Për të parë këtë “intertekstualitet”, le ta analizojmë pjesën fabulare të veprës “The Lord of the Rings”.

Jeta e Frodo Baginsit, jetimit të rritur nga xhaxhai i tij Bilbo, merr kthesë pikërisht në ditëlindjen e tij të 33-të (e cila ishte ditëlindja e 111 e Bilbo-s gjithashtu). Atij i ngarkohet

unaza, që i përkiste magjistarit më të ligë Sauronit. Frodo duhet ta shpie atë unazë të ligë deri tek vendi ku edhe është krijuar në Mordor, pasi që ai është vendi i vetëm ku mund të asgjësohet. Unaza e tërheq Frodo-n të bëhet i ligë dhe t'i vë në vend urdhrat e Sauronit. Libri tregon për shoqërinë e unazës, shoqëria me Frodon në krye që ka për detyrë ta shkatërrojë unazën dhe për pengesat që shfaqen gjatë rrugës së tyre për në Mordor. Frodoja, Semi, Gandalfi, Aragorni, Legolasi dhe shumë të tjerë janë protagonistët e kësaj ngjarje. Antagonistët, janë gjithashtu të shumtë, si: Sauroni, Kalorësit e zinj, Sarumani etj.

## **“Harry Potter” përballë “The Lord of the Rings”**

Libri “The Lord of the Rings” përmban elemente të shumta fantastike dhe imagjinate, të cilat e kanë nxitur, me ose pa dashje edhe vetë autoren e “Harry Potter”it të marrë aq shumë nga kjo kryevepër e mrekullueshme. Të krahasojmë së bashku në njëzet pika të përbashkëta, e që janë tejet të hetueshme nga secili lexues vëmendshëm:

1. Personazhi kryesor; “Harry Potter” ishte jetim, pas vdekjes së prindërve ai ishte rritur nga xhaxhai dhe tezja e tij. Frodo Bagins, personazhi kryesor i “The Lord of the Rings”, gjithashtu ishte jetim dhe pas vdekjes së prindërve ishte rritur nga xhaxhai i tij, Bilbo Bagins.
2. E gjithë ngjarja fillon pikërisht në ditëlindjen e 11 të Harry-t dhe në ditëlindjen e 33 të Frodos. A u duket e rastësishme ditëlindja?!!
3. Si Harry-t, ashtu edhe Frodo-s iu ngarkohet një detyrë jo e lehtë për moshën që kanë. (Frodo, edhe pse 33 vjeç, njihet si i mitur në mesin e hobitëve që jetonin nga një shekull.) Edhe nga pamja fizike, këta dy personazhe kanë ngjashmëri.
4. Gjithashtu, gjatë aventurave, pranë tyre gjenden gjithmonë shokët e tyre besnikë. Roni, shoku i ngushtë i Harryt dhe Semi shërbëtori besnik i Frodo-s. Si Semi, ashtu edhe Roni, nuk lakmojnë në lavdinë e shokut të tyre, të cilët gjithmonë janë në qendër të vëmendjes.
5. Simboli i urtësisë dhe i së pamposhturës tek “Harry Potter” është Urtimori, një plak, me flokë dhe mjekër të bardhë, i cili i njihet në një fshehtësi të botës. Ndërsa, tek “The Lord of the Rings” ky plak i gjithëdijshëm, flokë e mjekër bardhë është Gandalfi, i cili, po ashtu është një magjistar i dashur nga të gjithë.
6. Qëllimi i të dy protagonistëve kryesorë është që ta mposhtin magjistarin më të ligë të të gjitha kohërave. Tek Harry, Fluronvdekja, ndërsa tek “The Lord of the Rings”, Sauroni.
7. Të dy këta antagonistë janë të etur për pushtet, të etur për të mbizotëruar në botë.
8. Për t’u bërë i pavdekshëm Fluronvdekja e ka ndarë shpirtin e tij në shtatë horkurusë, të cilat janë gjëra të vlefshme. Njëri prej horkurusëve është pikërisht një unazë. Ai që i mban këta horkurusë afër, udhëhiqet nga e keqja. Këta horkurusë mund të shkatërrohen vetëm në mënyrë specifike. Po kështu, edhe Sauroni pushtetin e ka vendosur në një unazë, që po të asgjësohet do të shkatërrohet edhe ai.

9. Gjithashtu edhe kush e mban unazën udhëhiqet drejt së ligës. Shkatërrimi i unazës mund të bëhet vetëm në një mënyrë, mu ashtu siç bëhet edhe shkatërrimi i horkurusëve.

10. Siç është Manteli i padukshmërisë te Harry që të bën të padukshëm, ashtu edhe unaza tek “The Lord of the Rings” po të vihet në gisht të bën të padukshëm.

11. Kalorësit e zinj tek “The Lord of the Rings” janë shndërruar në Marrosës tek “Harry Potter”. Këto janë krijesa që mbajnë mantele të zinj me kapuçë dhe nuk shohin, por udhëhiqen nga shqisa e nuhatjes.

12. Shpata e Grifartit tek Harry, që paraqet shpatën e pamposhtur tek “The Lord of the Rings” është shpata e Isildurit.

13. Ashtu siç e ka rolin Shoqëria e Unazës për ta shkatërruar Sauronin, ashtu e ka rolin edhe Urdhri i Feniksit që ta shpëtojë botën nga Fluronvdekja.

14. Zogu, i cili shpëton Gandalfin shndërrohet në Feniks tek “Harry Potter”i dhe shpëton Urtimorin gjithashtu.

15. Një krijesë tjetër që luan rolin e njëjtë si tek “The Lord of the Rings”- Gollum-i, ashtu edhe tek “Harry Potter” është Kriçeri. Këto janë krijesa të vogla, të liga e të pista që shumë herë arrijnë t’u shkaktojnë dëme protagonistëve.

16. Merimanga gjigante me të cilën luftojnë Frodo dhe Sem, tek Harry merr emrin Aragog dhe me të luftojnë, po ashtu edhe Harry me Ronin.

17. Katanatë gjigantë tek “Harry”, janë njerëzit e stërmëdhenj (trolls) tek “The Lord of the Rings”.

18. Edhe pse të mitur, si Harry ashtu edhe Frodo kanë ndikim të madh në mundjen e antagonistëve kryesorë të veprave.

19. Në natën e Hallouinit Harry, Roni dhe Hermiona luftojnë një përbindësh, mu ashtu siç e luftojnë një përbindësh të ngjashëm edhe Shoqëria e unazës.

20. Siç e reflekton pasqyra e dëshirave, tek “Harry” njeriun ashtu siç ka dëshirë të jetë, tek “The Lord of the Rings” këtë rol e ka uji, i cili e shfaq fundin e zemrës së njeriut.

Përfundimisht, pa hyrë në detaje si emra të shumtë të njëjtë të përdorur si tek “The Lord of the Rings”, ashtu edhe tek “Harry Potter” huazimi i këtij të fundit mbi të parin është më se i qartë. Prandaj, “Harry Potter”, nuk asgjë tjetër veçse reflektim (për fëmijë) i veprës madhështore “The Lord of the Rings”, për të mos thënë “një mbindërtim i egër”; një huazim i pamëshirshëm tematik dhe tekstual.

*(Autorja ndjek leksionet në “Mileniumin e Tretë”, Prishtinë)*


# ROMAN I ERUDICIONIT TË THELLË

(Dan Brown: “Simboli i Humbur”)

(Botuar në gazetën “Kosova Sot”, 20 shkurt 2010)

Shkruan: Kreshnik Deliu

## KODI TEMATIK dhe DISKURSI



Kjo vepër, si gjithë tjerat të Dan Brown-it, tërheqë lexuesin me misteret që libri mëton t'i shfaqë. Zhvillimi i ngjarjes përcakton edhe toposin e veprës: Uashington D.C.-në. Tema e veprës është baza e ndërtimit, por që gjithnjë si një hije përvijohet prania e saj, ndërsa nuk identifikohet në mënyrë të plotë gjerë në përfundim. Kjo temë ka të bëjë me njohuritë e ashtuquajtura “antike” apo të “humbura”, të quajtura edhe në shumë mënyra tjera, të cilat kishin fuqinë e shndërrimit të poseduesit të tyre në qenie mbinjerëzore, apo, siç preferon ta quajë autori, në perëndi. Ky proces krijon lidhjen me faktorin e rëndësishëm në vepër, d.m.th. shoqërinë ‘masonike’, fakt ky që veprën e mbush me plotë mistere e fshehtësi / sekrete. Tema vetvetiu i dhuron kahje diskurseve të përdorura gjatë shtjellimit të ngjarjes. Më i veçuari ndër ta është ai fantastik, pa i dhënë kahje të largëta me realitetin, por gjithnjë duke e gërshtuar imagjinatën me fakte, të cilat i përdredhë duke ia përshtatur gjithnjë e më mirë imagjinatës së tij. Shpesh haset dhe diskursi historik, me faktet e përmendura, për të plotësuar veprën me informacione shtesë, pastaj diskursi retorik me rastin e ligjërimeve të ndryshme etj. Kur jemi tek diskutet, vlen të cekët se lehtë mund të identifikohet edhe përdorimi i shpeshtë i simboleve si bartës të informacioneve, duke e bërë këtë përdorim formë komunikimi.

Në të shumtën e rasteve kemi retrorrefim; ngjarja tregohet nga narratori në vetën e tretë, jo si i gjithëdijshtëm, për arsye se efekti i kureshtjes për të kuptuar, reflektohet në stilin e autorit. Ky narrator, edhe pse jo i gjithëdijshtëm, herë pas herë, në mënyrë spontane, lëshon ndonjë opinion të vetin mbi ngjarjet, duke e mbajtur prapë një distancë si narrator i vetës së tretë. Autori shpesh del nga këto korniza të rrëfimit duke shtuar edhe elemente tjera që veprën e bëjnë më të veçantë.

Si figurë narrative, proleksa vërehet shumë shpesh në rrëfim, mirëpo e adaptuar në një farë mënyre në një stil të veçantë të autorit. Kjo pasi që autori i dhuron lexuesit vizione të së ardhmes, sikur të ishin ato mendime të narratorit. Mirëpo, këto vizione të cilat pasojnë shtegun e shtjellimit të ngjarjes, deri tek vet vizioni, nuk dalin gjithnjë të sakta duke shtuar kësisoj edhe më shumë dyshimin e lexuesit për rrjedhjen e ngjarjeve në vazhdim. Koha e

rrëfimit gjithnjë është objektive, duke pasur një rrjedhshmëri shumë natyrale të kohës. Personazh kryesor i veprës vazhdon të jetë profesori Robert Langdon, i cili identifikohet edhe në veprat e mëhershme, andaj vepra në fjalë mban lidhjen e saj me botimet e mëhershme. Përkundër këtij fakti, lexuesi nuk është aspak i varur nga veprat e kaluara për ta kuptuar shtjellimin e ngjarjes në këtë vepër.

Ideja bazë e ngjarjes është dëshira e pareshtur e njeriut për zgjerimin e spektrit të dijes deri në kufijtë më të mistershëm të njerëzimit. Ndërsa kjo përcillet me shumë mesazhe të prezantuara apo të nënkuptuara për shumë sfera të jetës.

## **MASONIZMI NË LETËRSI** (Dy hipoteza)

Vija narrative dhe dinamike e Brown-it, e nisur në veprat e mëhershme vihet re qartë në fabulën e veprës, pasi ajo është ndërtuar me personazhe po thuajse të njëjtë, e pa lënë anash këtu dhe simbolizmin dhe misteriozitetin të përfshirë jo rrallë herë. Profesori, me të cilin disave nga ne na ishte dhënë rasti ta njohim dhe më herët në “Kodin e Da Vinçi-t” apo tek “Engjëj dhe djaj”, kësaj here mashtrohet nga një mendje e fuqishme me qëllime të këqija dhe futet në lojë të rrezikshme, ku si për trofe ka mikun e tij të dashur, jeta e të cilit vihet në rrezik. Prof. Langdon kalon nëpër shumë faza të zhvillimit të ngjarjes, viziton vende të ndryshme që bartin një vlerë të madhe, kalon sfida të shumta, të cilat i shfaqen edhe lexuesit, luan gjithnjë një lojë njohurish, gjerë në fund ku konkludohet e gjithë fabula dhe arrihet në një rezultat njohurish të reja. Përshkrimi i detajshëm i “organizatës së masonëve”, duke përfshirë këtu ritualet sekrete, qëllimet e tyre, mënyrën e brendshme të organizimit, të bën të dyshosh mbi qëllimet e autorit në këto përshkrime. Analizimi dhe shqyrtimi nga këndvështrime të ndryshme çon në dy hipoteza më të arsyeshme mbi qëllimet e këtij lloji të përshkrimit.

1. Autori bënë pjesë në organizatën e masonëve dhe përdor reputacionin e tij si shkrimtar për të krijuar një përshtypje tjetër më të mirë për masonët në publik, duke marr parasysh faktin se, masonët tani vetëm kanë krijuar një përshtypje jo shumë të mirë tek pjesa tjetër e popullsisë. Një nga arsyet e kësaj përshtypjeje është edhe fakti se nuk dihet edhe aq rreth qëllimeve të tyre, duke e arsyetuar me këtë dëshirën e autorit për të dhënë më tepër informacion.
2. Hipoteza e dytë është shumë e ngjashme me të parën, përveç se mund të jetë se autori nuk bënë pjesë në organizatë, mirëpo ndikimi i tyre vërehet qartë. Për këtë arsye mund të jetë dhe fakti tjetër se autori thjesht nga reputacioni i tij ka fituar mbështetjen e masonëve dhe për këtë arsye si këmbim në tekstet e tij shfaq atë që atyre iu duket e nevojshme për tu shfaqur dhe publikuar.

## **“SIMBOLI I HUMBUR” dhe “KODI DA VINCI”**

1. Protagonisti i njëjtë- Robert Langdoni ‘shëtit’ ndër veprat e autorit, duke ngërthyer elemente të përbashkëta në të gjitha veprat.
2. Përfshirja e misterit- Misteri dhe sekreti nga përdorimi aq i shpeshtë, pothuajse shndërrohen në një figurë, që në çdo përdorim të saj ka aftësi të ngjalljes së kureshtjes

dhe krijimit të ndjenjave tjera te lexuesi. Këto ndjenja thuhet janë të njëjtat me ato që krijohen kur lexohen edhe veprat tjera të Dan Brown-it.

3. Dinamika e ngjarjes- Kjo ka të bëjë me zhvillimin e fabulës së veprës, mënyrë e hasur dhe më parë. Zhvillimi i ngjarjes karakterizohet nga vetë stili i autorit, i cili bënë që ngjarja të jetë gjithnjë në lëvizje, freskon skenën me gjëra të reja, vende, informata, personazhe, probleme etj., për të krijuar kështu një “dinamik të zhvillimit të ngjarjes”.

4. Kërkimi i së vërtetës- Në tërë shtjellimin e ngjarjes vazhdimisht kërkohen njohuri dhe informata. Kërkimi i së vërtetës përshkon rrugë të ndryshme. Ky kërkim ka efekt qenësor në zhvillimin e ngjarjes duke i dhënë asaj kahjen dhe drejtimin pothuajse në të gjitha veprat e autorit, që krijon hapësirë trajtimi si element intertekstualiteti.

5. Përndjekja nga autoritetet- Krijimi i këndvështrimeve të ndryshme në tekst krijon mundësinë që personazhet të punojnë në interesa të kundërta ndaj njëri-tjetrit. Kështu ndodh edhe kur flitet për forcat e rendit dhe protagonistin që përndiqet.

6. Ballafaqimi me persona në poste të rëndësishme- Për t'i shtuar befasishtë dhe për të tërhequr më shumë vëmendjen, autori gjithnjë përdorë poste të rëndësishme të jetës reale dhe persona autoritarë për përfshirjen e tyre në ngjarje.

7. Përfshirja e organizatave të fshehta- Opinioni autori e tërheq afër duke ia zgjuar kureshtjen edhe me përdorimin e reputacioneve të organizatave të fshehta që përvijohen e lënë gjurmë në çdo botim të tij.

8. Zhvillimi i ngjarjes në objekte të ndryshme historike me shumë vlerë- Për ta rritur vlerën e veprës edhe më shumë, radhitën objekte të ndryshme si topos, për t'i ofruar lexuesit eksperiencë ndoshta të pa përjetuara ndonjë herë. Këto topose vetvetiu mbartin te lexuesi mesazh të vlerës dhe rëndësisë së tyre reale.

9. Miqësia e vjetër në kohë të vështira- Konkludimi i fabulës vjen shpeshherë në një pikë kur e vetmja shpresë për tu mbështetur është miku. Kjo mund të identifikohet në veprën në fjalë sikurse edhe tek vepra “Kodi Da Vinçi”.

Të gjitha këto elemente hasen lehtë pothuajse në të gjitha veprat e Brown-it, duke krijuar kështu mundësi intertekstualiteti ndërmjet tyre. Mirëpo, gjithashtu kuptohet se, këto mund të jenë vetëm veti të stilit të të shkruarit të këtij autori, apo konkretizim i mënyrës së tij të shtrimit narrativ të ngjarjes. Në këtë rast shqyrtimi kalon në trilogji apo dhe më tutje.

Përfundimisht, romani më i ri i Dan Brown-it, ashtu si “Kodi...” është roman i erudicionit të thellë, që hap tekstin ndaj interpretimeve të llojllojshme, për çfarë mund të hamendësohet loja me fiksonin. Autori lirisht mund të quhet autor “i pastër”. Mirëpo kjo pastërti mund edhe të diskutohet pa e cenuar vërtetësinë, nëse merret parasysh intertekstualiteti, që na kthen në çështjen gjyqësore të “Kodit të Da Vinçit”, kur u shqyrtua autorësia e vërtetë e librit e vënë nën dyshim nga disa akuzues, gjoja për plagjiaturë. Në atë rast u vërtetua autorësia e plotë e Dan Brown-it, andaj këto kritika bien poshtë, që do të thotë se autori është krijuar i pastër i kësaj vepre.

*(Autori ndjek mësimet në shkollën jopublike “Mileniumi i Tretë”)*

## “Darka...” e Kadaresë një tragjedi shekspiriane

(Botuar në gazetën “Koha ditore” 3 prill 2010)

### Shkruan: Zana Buçinca

Shkrimtari i madh, Ismail Kadare, ka mahnitur lexuesin shqiptar edhe me një vepër të tij, pikërisht me romanin “Darka e gabuar”. Mbi enigmën e kësaj ‘darke’ që ka trazuar qytetin e Gjirokastrës që më parë, e ende ka mbetur nën mjegullën e paqartësisë së plotë, Kadare, ka ndërtuar romanin tragjik, i cili në muajin maj do të shfaqet edhe si dramë në Teatrin Kombëtar në Tiranë. Dramë, e cila pritet me padurim, njëkohësisht, e krahasueshme me vetë “Mbretin Lir” të Shekspirit.

### Tema, figura dhe diskursi

Që nga titulli, autori vë në dijeni lexuesin edhe për vetë temën e veprës. Një darkë e gabuar është tema, e cila shtjellohet gjatë tërë romanit. Por, përse kjo ishte një darkë “e gabuar”? Çfarë ndryshonte kjo darkë nga një darkë e zakonshme? Janë këto pyetje, të cilat ia shtron lexuesi vetes që në fillim të romanit. Pra, shihet që vetë titulli i veprës është një lloj proleksi, duke i dhënë lexuesit që në fillim vetë “cakun e përfundimit” të romanit. Por, njëkohësisht duke shtuar kureshtjen për të gjetur shtigjet, të cilat i japin kësaj darke epitetin “e gabuar”.


Autori është bazuar në ngjarje të vërtetë. Pra, darka, për të cilën bëhet fjalë ka ndodhur me të vërtetë, gjë që e fut në “lojë” faktografinë dhe historicizmin, elemente, të cilat i japin romanit karakteristika të një vepre postmoderne.

Krahasimi i gjendjes së sunduesve në Shqipëri, me raportin ndërmjet dy doktorëve, janë dy paralele të cilat autori i tërheq ndërmjet dy temave të ndryshme, duke e përdorur kështu edhe një element tjetër postmodern, “paralelizmin tematik”.

Autori, këtu pozicionohet si narrator i gjithëdijshëm. Por, edhe pse i gjithëdijshëm, narratori i kursen detajet, të cilat do ta shpinin lexuesin drejt një hipoteze të saktë të përfundimit të romanit, duke lënë kështu hapësirë të krijohen hipoteza të tjera, larg nga ajo që do të ndodhë me të vërtetë.

Romani “Darka e gabuar” si topos ka Gjirokastrën, qytetin e lindjes së vetë autorit. Koha, këtu është objektive, pasi që ngjarjet zhvillohen sipas rrjedhës së tyre pa “kërcyer” nëpër kohë. Elemente, të cilat e bëjnë ngjarjen të marrë përmasa reale nga ana e lexuesit.

Pasi që, në vepër bëhet fjalë kryesisht për ndërrimin e regjimeve dhe sundimtarëve, autori shpreh edhe idetë e tij me anën e diskursit ideologjik. Diskursi mitik po ashtu është i përdorur, kur narratori rrëfen legjendën rreth ftesës për darkë, që i është bërë një të vdekuri.



Kjo, legjendë përmendet sikur kalimthi që në fillim të librit, por është pikërisht kjo që i jep lexuesit të vëmendshëm një shteg drejt përfundimit të ngjarjes.

Në këtë roman kryesisht dominon rrëfimi dhe vërehet një mungesë e dialogut. Gurametoja i madh dhe Gurametoja i vogël, dy doktorët, personazhe kryesore, përmes të cilëve jep gjendjen e Shqipërisë në atë kohë, duke i krahasuar njëri me tjetrin, për t'i shndërruar doktorët në një "njësi matëse" për fuqinë që e kishte Gjermania e Gurametos së madh dhe Italia e Gurametos së vogël.

Si nga një vepër e Kadaresë, këtu mund të nxirren mesazhe të shumta. Por, atë çfarë autori ka dashur të vë në dukje, është pikërisht padrejtësia e regjimit komunist, që vërtetohet nga vetë dënimi i Gurametojeve pa pasur dëshmi për asnjë nga akuzat e rrejshme.

### **Sinopsisi, linjat fabulare**

Gurametoja i madh dhe Gurametoja i vogël, dy personazhet kryesore, krahasohen që në fillim të librit. Fillimisht, Gurametoja i vogël ka epitetin "fitimtar" pasi që edhe vetë Italia ishte sunduese në Shqipëri. Por, pas largimit të italianëve, e hyrjes së gjermanëve, "fitues" në mes të dy doktorëve del Gurametoja i madh.

Këtu, edhe fillon të shtjellohet ngjarja kryesore e veprës. Gjermanëve që kishin kërkuar paqe dhe vetëm kalim në Shqipëri, me hyrje në Gjirokastrë iu qëllohet pararoja e tyre. Kështu, gjermanët fillojnë të gjuajnë drejt qytetit, derisa nga nuk i dihet se ku ngrihet një pëlhurë e bardhë në kërkim paqeje. Gjuajtja ndalon dhe qyteti kthehet në heshtjen e mëparshme. Është pikërisht pjesa e dytë e ditës, pra mbrëmja e kësaj dite, e cila është përmendur qindra herë nga vetë banorët e këtij qyteti, po edhe të shumë vendeve të tjera. Edhe pse e përmendur shumë, çfarë kishte ndodhur më të vërtetë atë natë askush nuk e dinte sigurt.

Ishte pikërisht doktor Gurametoja, që kishte ftuar kolonelin gjerman Fritz von Shwabe dhe disa gjermanë të tjerë në atë darkë, që më vonë u quajt si e gabuar. Fritz von Shwabe kishte qenë një shok universiteti i Gurametos dhe kishte ardhur me dëshirë në Shqipëri, pikërisht që ta shihnte mikun e tij të dashur. Se çfarë u fol saktësisht gjatë darkës nuk i dihet, por çfarë u bë e qartë ishte se doktori kishte bindur mikun e tij që t'i lironte 80 pengjet që do të ekzekutoheshin si ndëshkim për vrasjen e pararojës gjermane.

Që, kjo darkë do të ishte arsyeja e ndëshkimit të doktor Gurametos së madh, askush nuk e kishte marrë me mend. Fillimisht, darka kishte qenë tema kryesore në qytet. Por, pasi që banorët kishin shtjelluar çdo hipotezë të mundshme për darkën dhe se çfarë i kishte thënë doktori kolonelit, që ky i fundit t'i lironte pengjet, ata ishin mërziur nga kjo temë dhe e kishin harruar për një kohë.

Kur, të gjithë mendonin se darka ishte harruar plotësisht dhe nuk kishte më ç'të diskutohej për të, ishte Vehip Qorri, ai i cili ua përkujtoi darkën banorëve edhe njëherë me ca vargje shumë të pakuptimta për të tjerët, por jo për Gurameton e madh.

*"Doktor, ç'bëre atë natë"*

*Thirre meitin (të vdekurin) për darkë".*

Nëse për të tjerët këto vargje ishin të pakuptimta, për Gurameton ishin ngjethëse. Nuk mund ta besonte si një i verbër që nuk kishte parë kurrë të gjallë me sy, mund ta dallonte atë nga një i vdekur.

Kaloi kohë, e u ndërrua regjimi. Gjermanët ikën e vendin e tyre e morën komunistët. Ndërsa ditët kalonin, ndodhi e papritura. U arrestuan Gurametoja i madh dhe Gurametoja e vogël.

Për shumë kohë nuk u dëgjua për ta, derisa u lajmërua se do të burgoseshin në Guvën e Shanishasë, vend ky i torturës së motrës së Ali Pashë Tepelenës dhe i pashkelur që atëherë.

Arsyeja, e burgosjes së doktorëve u mor vesh shumë kohë më pas. Ata, ishin menduar të kishin kryer krime në sallën e operimit, kundër liderëve komunistë. Por, pas hetimit të çështjes, hetuesit i shpallën doktorët të pafajshëm nga kjo akuzë. Ata mbaheshin ende në Guvën e Shanishasë. Tani, hetimi kishte marrë kahje tjetër dhe hetuesit filluan ta pyesnin Gurameton e madh rreth darkës, në të cilën ky i fundit ishte takuar me mikun e tij të universiteit. Gurameto nuk pranoi se aty kishte ndonjë enigmë, kështu që ai u dënua me vdekje për shkak se miku i tij Fritz von Shwabe kishte vdekur 3 vjet para darkës së famshme. U kuptua se ai që kishte luajtur rolin e Fritzit kishte qenë një shok i këtij të fundit, të cilit Fritzit i kishte treguar shumë çka rreth shokut të tij të universitetit.

Ngjarja në këtë roman, përfundon me vdekjen e doktor Gurametos së madh, i cili duke shkuar në ekzekutim, siç ishte pa ndjenja mundohet të thotë diçka, kur kalojnë pranë varrezave. E që më vonë kuptohet, se sikur kishte dashur ta hiqte ftesën nga varri i tij, nga ai varr i përrallës që gjyshja ia kishte treguar që kur kishte qenë në djep. Kishte dashur që para vdekjes ta hiqte ftesën e darkës që e kishte marrë në qafë.

### **Gurametoja i madh, personazh shekspirian**

Siç shihet “Darka e gabuar” qenka një tragjedi moderne. Por, a mund ta krahasojmë këtë tragjedi moderne me një tragjedi të mbarënjohur? A mund ta krahasojmë Gurameton e madh të “Darkës së gabuar” me “Mbretin Lir” të Shekspirin? Po!

Një përfundim tragjik pësojnë që të dy personazhet, si Liri ashtu edhe Gurametoja i Madh. Të dy këta të fundit kishin qëllime të mira, Liri që ta ndante pasurinë dhe fuqinë e tij, ndërsa Gurametoja t’i shpëtonte pengjet të cilat ishin marrë. Qëllimet e tyre keqkuptohen, Liri tradhtohet nga vetë të bijat, në anën tjetër Gurametoja merret si tradhtar i kombit. Vdekja e Lirit dhe vdekja e Gurametos, është përfundimi i këtyre dy tragjedive madhështore. Njëra e shkruar shekuj më parë, ndërsa tjetra e saposhkruar.


Përfundimisht, romani “Darka e gabuar”, tashmë i dramatizuar dhe i cili do të shfaqet në maj të këtij viti, patjetër që do të ‘trondisë’ publikun, ashtu siç ka bërë “Mbreti Lir” bërë kohë më parë. Po, sepse “Darka” është një dramë e krahasueshme me “Mbretin Lir”, Gurametoja i madh është një personazh i krahasueshëm me Lirin, dhe Kadare, një autor i krahasueshëm me Shekspirin.

## Një novelë e çuditshme

(Botuar në gazetën “Lajm”, 3 prill 2010)

(Dean Koontz: “Odd Hours” (Orët e çuditshme), BANTAM BOOKS, New York, 2008)

Shkruan: Doresa Kabashi



Dean Koontz është një autor profilik, i cili ka shkruar mbi 80 novela, të cilat janë përkthyer në mbi 38 gjuhë. Kopjet e librit të tij janë jashtëzakonisht shumë të shitura. Ato arrijnë numrin prej mbi 17 milion në vit. 11 novela të tij janë ranguar në listën e librave më të shitur të “New York Times”, duke e futur këtë autor në grupin e 12 autorëve që kanë bërë një sukses të tillë. Shumë libra të tij janë kthyer, po ashtu janë bërë edhe filma artistikë.

### “Odd Hours”, novelë e karakterit

“Odd Hours” është libri i katërt në serinë e famshme të Dean Koontz-it me personazhin tejet të famshëm, Odd Thomas-in. Odd është një djalosh i mirë dhe shumë i këndshëm, i cili që në takim të parë do të linte gjithsesi përshtypje shumë të mira. Për nga profesioni, Odd është një djalosh kuzhinier, i cili punon tek shtëpia e një aktori në moshë tejet të shtyrë. Odd vishet gjithnjë me xhinse e kanatiere komode, tamam si një djalë i ri.

Sidoqoftë, Odd ka një numër të madh dhuntish. Kjo e bën atë të veçohet nga njerëzit e zakonshëm, ngase ai i përdorë ato duke iu dalë në ndihmë njerëzve.

Karakterit i Koontz-it, Odd, sheh fantazma. Ai nuk mund t’i dëgjojë, por fantazmat mund të komunikojnë me të, po në të njëjtën mënyrë. Ai, po ashtu ka një dhunti tjetër, e cila quhet “magnetizëm psikik”, e cila e tërheq personin mbi të cilën ai fokusohet. Odd, përveç “magnetizmit psikik”, sheh dhe krijesa në formë jo të definuar, por vetëm në hije, të cilat specifikohen me një emër të veçantë si “bodachs”. Këto krijesa paraqiten në vendet ku pritet të ndodhë një tragjedi. E keqja e krijesave hije është se ato mund të shohin njerëzit edhe nëse njerëzit veprojnë anasjelltas. Për këtë arsye, Odd duhet të jetë shumë i kujdesshëm.

Tek “Odd Hours” ne e gjejmë Oddin në qytetin e Kalifornisë. Ai nuk e di arsyen pse gjendet pikërisht në atë vend, mirëpo ai sheh ëndrra me një vajzë të quajtur Anamaria, e cila është 18 vjeçare dhe është shtatzënë. Fundi është i paparashikueshëm. Oddi shpëton Anamarinë dhe miliona jetë të tjera. Me një fjalë, Odd Thomas është prej personazheve më të dashur dhe të pëlqyer nga vetë autori. Ai është një djalosh, i cili ka dhunti të çuditshme, por që mban një pafajësi të pazakontë. Ai është një djalosh, me të cilin, çdo prind do të ishte krenar po ta kishte fëmijë.

## Narracion argëtues me mesazhe të mëdha

Veçantia e gjithë kësaj novele ka të bëjë me temën e saj dhe mënyrën sesi është shtruar. Gjatë leximit të saj ne kuptojmë që autori na paralajmëron në mënyrë indirekte për vazhdimin e padyshimtë të kësaj ngjarjeje të gjatë edhe në libra tjerë. Roli i Anamarias mbetet mistik edhe në fund të librit, duke mos u thelluar në asgjë dhe duke e lënë kështu si një personazh tejet të etshëm për zbulim apo demaskim pozitiv.

“Odd Hours” është një novelë e këndshme për lexim, pasi që nuk të krijon monotoni në asnjë moment dhe e ka teknikën e kalimit të shpejtë në ngjarje të ngërthyer në mënyrë perfekte. Personazhet e kësaj novele nuk kanë karakteristika të përziera apo ndryshe “gri-përhirtë”, personazhet janë të ndarë me një kufi shumë të qartë, ose janë të mirë, ose janë të këqij. Kjo novelë përmban elemente të shumta postmoderne, pasi që autori luan me kohën, figurat, ngjarjen etj., Mirëpo, gjithnjë iu qëndron besnik kufijve të personazheve. Novela i përket zhanrit fikcional, mirëpo falë mjeshtërisë së autorit, tema e saj të duket sikur diçka shumë reale edhe pse në mendim të parë të duket shume kontroverse. Nëse di rreth jetës së autorit dhe, nëse lexon një biografi të thellë rreth tij, do të duket sikur edhe këtu po ndodh diçka e ngjashme. Autori, si një piktor i rrallë vijëzon portretet e personazheve, e që në këtë rast, duket sikur pasqyron karakteristikat e personalitet të tij; disi sikur prek biografinë duke mos u thelluar fort, duke ditur të mbajë mjeshtërisht limitet narrative. Kur të përfundoni një libër të tillë do të ju mbetet ajo ndjenja tejet e mirë dhe pozitive për personazhin kryesor, si dhe do të ju duket sikur edhe do të mund t’i besoni atij sikur të ishte në jetën reale. Një gjë dihet, një person si Odd kurrë nuk do të ju kthente shpinën, apo t’ju linte në baltë. “Odd Hours” është një novelë interesante, e cila nuk njeh sa dhe si duhet kufijtë mes faktit dhe fikcionit, novelë e cila di të argëtojë dhe të mbaj afër tërë kohën lexuesin me mesazhet e mëdha për jetën. Pra, siç thotë dhe vetë Odd: “It’s only life. We all get through it.” (Është vetëm jeta. Të gjithë e tejkalojmë atë).

## Mendime për librin

“Koontz është ai i cili të ofron momente melodramatike të kompletuara me qeshje në maksimum, momente të ngrënies së thonjve, dhe të befason në fund me narracion argëtues.”-*Booklist*

“I mirë, me kënaqësi të pastër...një ngjarje e këndshme mbi njerëzit të mirë e të këqij, mbi shpresën e humanitetin...prozë poetike perfekte...” Si Odd Thomas, Koontz nuk e lejon veten e tij që të bëhet shumë serioz, por aty qëndron një thellësi në të dytë që shtrihet që në përshtypjen e parë.” *Winston –Salem Journal*”

“Një prej karaktereve më të shquar e tërheqëse në fiksjonalen e sotme...e shkruar bukur...një literaturë e këndshme për lexim pasditeve në shtëpi”-*Virginian –Pilot*.

## “Dear John”, film për dashurinë ideale

(Botuar në gazetën “Lajm”, 3 prill 2010)

**Jora Lumezi**  
**Diora Binxhiu**

Çfarë do të bëni me një letër që ndryshon çdo gjë? “Dear John” është një film që mund të shpjegojë pse shkrimi në letër ka rënë në sy të keq. Letrat janë të ngadalta, kanë tendencë të shurdhër dhe ato shpesh të lënë me një ndjenjë se më shumë mund të jetë thënë. Ato shpesh kthehen edhe në lajme jo të mira, ashtu si në “Dear John”. Nicholas Sparks, një autor shumë i njohur librash shkroi dramën “Dear John” në formë të librit në vitin 2006, ndërsa si film u realizua më 5 shkurt 2010 me regjisor: Lasse Hallstorm, producent: Ryan Kavanaugh, Marty Bowen, Wyck Godfrey dhe skenarist: Jamie Linden. Por, sidoqoftë letrat të cilat gjithmonë fillojnë me “I Dashur...” të dhimbshme kanë efektin e tyre.



### Kur letrat të mbajnë gjallë

John Tyree (Channing Tatum), është një ushtar i cili bie në dashuri me një vajzë të re Savannah Curtis (Amanda Seyfried). Savannah ishte në pushimet pranverore kur për herë të parë takoi Johnin, i cili ishte kthyer në shtëpinë e tij për një kohë të shkurtër. Për ushtarin, takimi me vajzën ishte dashuri me shikim të parë. Gjatë rrjedhjes së shtatë viteve të ardhshme që Johni ishte në ushtri. Secili vend që ndodhej ishte në rrezik më të madh se vendi i kaluar dhe letrat e Savannes ishin të vetmet që e mbanin gjallë. Megjithatë, këto korrespondenca dashurie dhe të përzemërta, në fund të fundit do të japin pasoja që as ushtari trim, e as tragjedia e tij nuk të mbeten pa u shijuar. Problemi kryesor i “Dear John” është se shumë herë kemi parë këtë lloj romance në mes një djali të butë me një të kaluar të errët dhe një vajzë të bukur e të pasur: puthja në shi, skena erotike, marrëdhënie dashurie në distancë etj...

Ky film ka një qëllim: të na ofroj një ngjarje reale.

### “Dear John” mund “Avatar”

Filmi “Avatar” i cili ishte në toplistë në vendin e parë për shtatë javë kishte nderin t’ia dorëzonte kurorën e tij për të sapoardhurin “Dear John”, i cili tani u bë kampion në toplistën e filmave më të shikuar në botë.

Yjet e filmit Amanda Seyfried dhe Channing Tatum fituan rreth 30.5 milion dollarë gjatë fundjavës së filmave “Super Bowl”.

Disa analistë të filmave besonin se kjo dramë do të ishte më e shikuar nga femrat. Ndërkohë Rory Bruer (udhëheqësi i Sony Pictures), i cili gjatë gjithë kohës ishte optimist, për filmin

tha: “Ne që në fillim kur pamë fotografinë e filmit ndjemë diçka, por kurrë nuk menduam se do të dilte aq mirë“.

“Historia jonë ka tri pjesë: një fillim, një mes dhe një fund. Edhe pse kjo është mënyra që të gjitha marrëdhëniet mbarojnë kështu, unë ende s’mund të besoj që kjo e jona s’do të zgjasë përgjithmonë.”- Nicholas Sparks (Dear John)

## Shënime për autorin

Nicholas Sparks lindi në Omaha, Nebraska, në natën e vitit të ri më 1966. Prej moshës katërbëdhjetë vjeçare ai filloi të mësoj dhe të mendoj si i rritur. Punonte tridhjetë orë në javë në një kafiteri. Gjatë përfundimit të shkollës së mesme Nicholas-i ishte tej mase i mërzitur, derisa nëna e tij e sugjeroi të shkruante një libër. Këtë ide e morri si asgjë dhe filloi të shkruaj. Tetë javë më vonë ai përfundoi novelën e tij të parë - “The Passing”, të cilën vendosi të mos e botonte. Më vonë ai shkroi shumë libra të tjerë si: “The Royal Murders”, “The Notebook” ( me të cilën fitoi 1,000,000 dollarë), “Message In The Bottle”, “ A Walk To Remember”, “The Last Song” etj.

Kritikë filmi

## “Avatar” si “Pocahontas” në 3D

*(Botuar në gazetën “Kosova sot”)*

**Shkruan: Bind Skeja**

Filmi “Avatar” i James Cameron-it është njëri ndër më të komentuarit e ditëve të fundit në fushën e kinematografisë botërore. Sipas Cameron-it, puna në “Avatar” ka filluar tek në vitin 1994, me një skript 80 faqesh. Filmi ishte planifikuar që të përfundohej më 1999, por Cameron-i thoshte se, ende nuk kishte arritur teknologjia e mjaftueshme për vizionin e tij të filmit. Prodhimi i filmit ka kushtuar rreth 280 milion dollarë dhe promovimi i tij mbi 150 milion, kurse fitimet janë më shumë se 2 bilion dollarë. “Avatar”, gjithashtu është nominuar për disa çmime akademike, ndër të cilat janë: “Fotografia më e mirë” dhe “Regjisori më i mirë”. Filmi në fjalë, ka arritur kulmin e popullaritetit dhe pritet me padurim që të vijë edhe në kinematë e Kosovës. Mirëpo, a jeni të sigurt, që nuk e keni parë më herët këtë film si të vizatuar?!

“Pocahontas” është prodhuar nga Walt Disney, me regjisorë Mike Gabriel dhe Eric Goldberg, i cili është vënë në kinema në vitin 1995. “Pocahontas” është nominuar për 11 çmime, 9 prej të cilave i ka fituar. Gjithsej, ky i fundit, i ka fituar rreth 300 miliardë dollarë. Megjithëse, James Cameron i mohon ngjashmëritë, ato vërehen qartë, madje edhe në detaje të vogla. T’i analizojmë së bashku, duke i vënë përballë njëri-tjetrit:

1. Protagonisti kryesor i “Avatar-it”, Jake Sully, dërgohet në një “botë të re” me një anije, ashtu siç ndodh me John Smithin, protagonistin kryesor në “Pocahontas”.
2. Ardhacakët në “Avatar” fillojnë të gërmojnë për një material shumë të çmueshëm, i cili shitet shumë shtrenjtë në tokë, përderisa kolonialistët në “Pocahontas”, gjithashtu kërkojnë për ari.
3. Kur Jake Sully (Avatar) takohet me një vendase në Tokën e re, vendasja në fillim dyshon tek ai, por pasi që e merr një mesazh nga Druri i Shpirtrave, ajo e krijon besimin e plotë. Në “Pocahontas”, John Smith takohet me Pocahontas, një indiane e bukur, e cila dyshon tek John Smithi, por pasi që bisedon me Gjyshen Shelg, ajo e ndryshon mendimin e saj.
4. Në “Avatar”, vendasja Neytri e mëson Jakein se si të bëjë gjueti, se si t’i zbusë kafshët, gjithashtu ajo atij i mëson historinë e popullit të saj, po ashtu në filmin vizatuar “Pocahontas”, personazhi Pocahontas, e mëson Johnin se si të bëjë gjueti, se si t’i rritë të lashtat dhe, po ashtu, i flet për historinë e popullit vendas.
5. Të dyja vajzat, Neytri (në “Avatar”) dhe Pocahontas (në “Pocahontas”), janë bijat e kryetarëve të fiseve të tyre, të cilat janë të detyruara të martohen me një luftëtar të madh, e që nuk e pëlqejnë aspak.
6. Gjatë kalimit të kohës Johni dhe Pocahontas në “Pocahontas”, dy njerëz prej botëve të ndryshme, dashurohen me njëri-tjetrin, ashtu siç dashurohen Neytri dhe Jakei në “Avatar”.
7. Si në “Avatar”, ashtu edhe në “Pocahontas”, protagonistin kryesor sulmohet nga luftëtari i madh për shkaqe xhelozie.
8. Tutje, ardhacakët e planifikojnë një sulm ndaj vendasve për të marrë materialet e tyre, kështu që John Smithi në “Pocahontas” dhe Jake Sully në “Avatar”, nga vendasit fajësohen si tradhtarë.
9. Si John Smithi në “Pocahontas”, ashtu edhe Jake Sully në “Avatar”, shpëtojnë në moment të fundit pasi që ardhacakët e sulmojnë fshatin.
10. Në “Pocahontas”, në fund të luftës, Pocahontas rrezikon jetën për Johnin dhe e shpëton atë. Njëjtë ndodh edhe në “Avatar” me Neytri-n, e cila shpëton Jakein, duke e rrezikuar jetën e saj. Në të dy rastet, protagonistët jetojnë një jetë të lumtur dhe konfliktet ndërmjet dy popujve zgjidhen.

Në rast se nuk jeni bindur ende, krahasoni sinopsiset e këtyre dy filmave:

## “Avatar”



Në vitin 2154, një anije e cila mban Jake Sully, njëri ndër personazhet kryesorë, mbërrin në një “botë të re” të mbushur me bimësi. Ardhacakët janë duke gërmuar për Unobtanium, për mbikëqyrjen e Kolonelit Quarich. Jake Sully fillon të eksplorojë territorin e ri dhe takohet me Neytrin. Në fillim ajo dyshon tek ai, por pastaj një mesazh nga Druri i

Shpirtrave i ndihmon që ta kapërcejë ankthin. Të dy kalojnë kohën së bashku. Neytri i ndihmon Jakeit të kuptojë që çdo jetë është e vlefshme dhe se natyra është e lidhur në një cikël jetësor. Gjithashtu, ajo e mëson se si të bëjë gjueti, të zbutë kuçedra dhe përherë i rrëfen për kulturën dhe historinë e popullit të saj. Babai i saj është kryetari Eytucan, i cili dëshiron që vajzën ta martojë me Tsu’Tey, një luftëtar i madh, por Neytri nuk e dëshiron. Gjatë kalimit të kohës, Jake dhe Neytri bien në dashuri. Njerëzit, të cilët mendojnë se vendasit janë të egër, planifikojnë që t’i sulmojnë ata për Unobtaniumin e tyre. Tsu’Tey nga xhelozia mundohet që ta vrasë Jakein, por ai vritet më vonë nga ardhacakët. Deri sa ardhacakët planifikojnë sulmin, Jakeu është i fajësuar nga vendasit dhe dënohet me vdekje. Pak para se ta vrasin, ardhacakët arrijnë. Kryetari Eytucan vdes dhe Jake lëndohet nga Kolonel Quaritch, i cili vdes pastaj nga disa shigjeta. Neytri e rrezikon jetën e saj për të shpëtuar Jakein. Jake dhe Neytri, më në fund shpëtojnë. Në këtë mënyrë, që të dy kulturat zgjidhin konfliktin në mënyrë paqësore.

## “Pocahontas”

Në vitin 1607, një anije e cila mban John Smithin, një kapiten i cili është edhe personazh kryesor në “Pocahontas”, mbërrin në një “botë të re” të mbushur me bimësi. Ardhacakët gërmojnë për ari, nën mbikëqyrjen e Guvernatorit Rattcliffe. John Smithi, duke eksploruar territorin e ri takohet me Pocahontas, një vajzë e re që i takonte një fisi të indianëve. Në fillim ajo dyshon tek ai, por pastaj një mesazh nga Gjyshja Shelg i ndihmon që ta kapërcejë ankthin. Pocahontas i ndihmon Johnit të kuptojë që çdo gjë në jetë është e vlefshme dhe se natyra është e lidhur në një cikël jetësor. Gjithashtu, ajo e mëson se si të bëjë gjueti, të rriten të lashtat, për kulturën dhe origjinën e saj. Babai i saj është kryetari Pouhatan. Ajo dëshiron të martohet me Kokoum, një luftëtar të madh dhe serioz, që Pocahontas nuk e dëshiron. Gjatë kalimit të kohës, John dhe Pocahontas bien në dashuri. Ardhacakët, të cilët mendojnë se vendasit janë të egër, planifikojnë që t’i sulmojnë ata për arin e tyre. Kokoum mundohet që ta vrasë Johnin nga xhelozia, por ai vritet më vonë nga ardhacakët. Deri sa ardhacakët

planifikojnë sulmin, Johni është i fajësuar nga vendasit dhe dënohet me vdekje. Pak para se ta vrasin, ardhacakët arrijnë. Kryetari, Pouhatan, gati vdes dhe Johni lëndohet nga Guvernatori Rattcliffe, i cili dënohet nga ligji në Angli. Pocahontas e rrezikon jetën e saj për të shpëtuar Johnin. Johni dhe Pocahontas më në fund shpëtojnë dhe dy kulturat krijojnë marrëdhënie paqësore

Përfundimisht, te këta dy filma ngjashmëritë janë të theksueshme. Ec beso nëse kjo ishte një ëndërr e Cameron-it, apo një kujtesë e mirë e filmit të fëmijërisë, “Pocahontas”!!

## “Lugina...” një ndër dhjetë librat më të lexuara

*(Jacqueline Susann : “Lugina e kukullave”, OMSCA-1, Tiranë, 2009)*

### **Shkruan: Dina Demiri**

Duhet të ngjitesh në majë të malit Everest, që të arrish në Luginën e Kukullave. Por, gjëja e fundit që do të prisje është të gjeje këtë luginë. Dhe e dini pse?! Sepse forcat e natyrës do të të kenë dërrmuar, shurdhuar, verbuar dhe të lënë tejet të kapitur për të shijuar fitoren. Jacqueline Susann, duke u bazuar në jetën e vërtetë të disa prej “yjeve” të Hollivudit, egoizmin, ironinë dhe dashurinë e saj e shprehë përmes personazheve të jashtëzakonshme. Të gjithë e dimë se pa asnjë vështirësi nuk ka sukses dhe në po të njëjtën situatë ishte kjo autore. Botimi i kësaj vepre hasi në shumë vështirësi, sepse në fillim nuk u pranua nga botuesit, ngase iu duk i papërshtatshëm për kohën. Por, sot e kësaj dite, sukcesi shihet. “Lugina...” është një ndër dhjetë librat më të lexuar të të gjitha kohërave.

Tema e këtij romani është temë individuale. Vuajtje, të cilat nuk e dinë kurrë fundin; shoqëri e tradhti nga ata që më së paku e prisje. Dhe si për sherr, të gjitha këto i ndodhin një vajze me fytyrë engjëjllore e të pafajshme, vajzë e cila sapo është shpërngulur në New York, nga qyteti i vjetër e i mërzitshëm Lorensvil. Çastet më interesante të jetës së saj, pamje nga më të papriturat ndodhin aty, në ato hapësira reale. Por, çfarë ndodh këtu, të bën të mendosh se hapësirat s’kanë të bëjnë fare me realitet, madje as që i afrohen. E ju mund të pyesni lirisht pse?

Ndodh kjo, ngase pas atyre kopertinave të thjeshta të librit, fshihet një roman shumë mbresëlënës, e me ndodhi, të cilat nuk do të donit t’ju ndodhin ju. Rrëfim rrëqethës, retrospektiv, introspektiv, që i përket një stili mjaft të lartë letrar. Këtyre rrëfimeve nuk u mungojnë as përshkrimet. Përshkrime të çuditshme, por shpeshherë të ëmbla. Nuk e di se nga e mori autorja tërë këtë inspirim. Mos vallë ajo u ndodh në një situatë të tillë? një pikëpyete që na ndjek gjatë tërë leximit.

Por, për një gjë jam e sigurt, motivi që ajo kishte është ai erotik. Hmmm...ndoshta e gjithë bukuria e romanit fshihet pas kësaj.

Sidoqoftë, personazhet, si pothuajse në çdo vepër tjetër, janë protagonistë dhe antagonistë. Protagonistja më zemërgjerë që mendja ime ndonjëherë kishte imagjinuar është Eni. Por, shumë keq që kishte zemër aq të butë, ngase shumica nuk ia dinin. Si p.sh., një protagoniste, e cila shumë shpejt u shndërrua në antagonistë – Nili. E verbëruar nga fama, ajo harroi shoqërinë e saj.

Pas leximit, shihet qartë se narratori është personazh, dhe mund të them se ka kohë që nuk kisha parë narrator më të singjertë. Gjithashtu, ka pak nga narratori i gjithëdijshëm (*ajo nuk do të kthehej kurrë në Lorensvil*).

Nga e gjithë kjo, vërehet se diskursi është personal. Diskurs që shihet qartazi kur personazhet rrëfohen si të çmendur për jetën që po bënin.

Edhe pse ka variante gjuhësore, më vjen mirë që autorja zgjodhi gjuhën standarde. Në njëfarë mënyre dhe neve na lehtësoi leximin.


## Fabula

E tërë ngjarja filloi në shator të vitit 1945, kur tri vajza të reja fillojnë një karrierë marramendëse, e cila i sjell deri tek vetë-shkatërrimi. Eni, e cila nga Lorensvili u shpërngul në New York, shpresonte që ky qytet do t'i sillte jetë krejtësisht të re. Ajo u punësua në një agjenci, që përfaqësonte Helen Lawson (një yll nga shfaqja "Hit the Sky"). Nili O'Hara ishte një fëmijë guximtar me shumë talent. Ajo jeton një kat më poshtë se Eni dhe falë shoqërisë me të, ajo fiton rol në kor të një shfaqjeje. Xhenifer North, një vajzë bionde kabareje, e cila është e rrethuar me meshkuj, shfaqet gjithashtu në atë show. Këto tri femra shumë shpejt arrijnë të bëhen shoqe shumë të mira. Shoqe, të cilat kanë prirje të ngatërrohen me meshkuj të gabuar.

Xheniferi ishte martuar me një princ evropian, por më vonë ajo zbuloi që ai nuk fitonte dhe aq shumë dhe kërkonte nga ajo të flinte me ekzekutivët e reklamave për kontrata. Si një nxënëse e shkollës private, Xheniferi kishte romancë me një shoqe të klasës nga Spanja, e cila ishte shumë xhelozë dhe zotëruese, prandaj Xheniferi e la. Kjo eksperiencë e kishte mësuar atë se vetëm paraja mund ta blinte lirinë, dhe që ajo nuk ka dëshirë të jetë e zotëruar nga askush. Me kthimin e saj në Amerikë, ajo fillon të "shoqërohet" me një këngëtar të klubit të natës, Toni Polar. Duke besuar se sjelljet e tij fëmijërore janë të ndikuara nga gjysmëmotra / menaxherja e tij Miriam, Xheniferi e bind Tonin që të arratisen për në Hollivud. Shkurt, pas kësaj ajo mbetet shtatzënë dhe ik. Miriam ia shpjegon se Toni vuan nga një sëmundje në tru dhe se fëmija mund gjithashtu ta trashëgoj. Me të dëgjuar këtë lajm Xheniferi vendos ta abortoj. Pirja e tepërt e duhanit dhe stresi atë e shndërrojnë në një vajzë që s'dinë c'është gjumi, për këtë arsye ajo përdor të famshmet - "kukullat".

Xheniferi më pas kthehet në Shtetet e Bashkuara, ku bie në dashuri me një senator republikan. Por ja që fati aspak s'ishte në anën e saj ngase, atëherë asaj i'u shfaq kanceri në gji dhe se s'bën fare të ketë fëmijë. Në shtrat, i dashuri i saj rreshtazi përmend se sa shumë i pëlqen gjoksi saj. Dhe kjo e bën të mendoj se si cdo mashkull, edhe ky e duan atë vetëm për trupin e saj. Xheniferi vetëvritet me një mbidozë të "kukullave".

Nili bëhet shumë e famshme në skenat e Broadway, shkon në Hollivud të punoj në filma, madje edhe arrin të fitoj çmimin Oskar. Por, sado e pasur e e famshme që ishte edhe ajo u bë e varur nga "kukullat", të cilat në njëfarë mënyre e shkatërruan. Por tashmë as këto nuk i mjaftonin saqë filloi të përdorte edhe Demerol. Vartësia e saj u rrit në një shkallë shumë më të lartë, se sa mund ta ketë paramenduar. Pas shumë tentimeve për vetëvrasje, Eni e dërgon



Nilin një spital psikiatrik. Pas lëshimit, ajo fillon të punoi me Lion Bërkun . Por e papritura fillon këtu...

Edhe pse Lioni ishte i martuar me shoqen e ngushtë të saj Enin, Nili s'do t'ia di. Ajo shëndrrohet në dashnore të tij. Kukullat e joshën aq shumë , saqë duket se është duke marrë tatëpjetën e fundit.

Eni është më e mira. Madje edhe në zyrë , bukuria dhe klasa e saj vërehet nga të gjithë. Me arritjen e saj ne New York, Alen Kuper dashurohet shumë shpejt në të, dhe gjëja e fundit që aj dëshiron është ta humbë. Por, zemra e Enit tashmë ishte rrëmbyer. Po, ishte rrëmbyer nga Lioni, i cili ishte avokat në zyrën ku ajo punonte. Kur Aleni e merr vesh, me inat ndahet nga Eni. Ajo mbeti e dashuruar në të me ditë , muaj, vite .. edhe pse ajo tashmë ishte një modele shumë e suksesshme, dhe kishte një lidhje dashurie me një më të moshuar. Lioni kthehet përsëri tek ajo, dhe nuk e di se si por ajo ia arriti që të martohet me të. Lindi një vajzë dhe emrin ia vunë Xhenifer , për shkak të shoqes së saj që u vetëvra. E shihni sa zemër të mirë ka???

Eni rriti vajzën, por në njëfarë mënyre më shumë e bëri punën vet, ngase Lioni edhe pse tashmë ishin të martuar, ai kishte lidhje me vajza të tjera , përfshirë dhe Nilin.

Fundja, askush si zëvendëson ato "kukulla" magjike.

## Përmbyllje

"Lugina e kukullave" u bë një fenomen në botimet letrare dhe suksesi i jashtëzakonshëm i romanit bazohet te njohja e femrave dhe e ëndrrave të tyre nga ana e Jacqueline Sussan-it, si dhe në përvojën e saj si aktore. Ky roman është një ndër dhjetë librat më të shitur të të gjitha kohërave. Roman që na mëson shumë. Na tregon se historitë e **bukura janë gjithmonë të bukura.**

P.S.

A thua "kukullat" janë kukulla ?

*(Autorja ndjek leksionet në shkollën jopublike "Mileniumi i Tretë")*

## Roman për krenarinë dhe paragjykimin

*(Botuar në gazetën: "Kosova sot", 3 prill 2010 dhe "Bota sot", 5 prill 2010)*

(Xhejn Ostin: "Krenari dhe Paragjykim", përkthyer nga Manushaqe Bako, Dritan, Tiranë, 2008)

### Shkruan: Buena Aziri

Ky libër, i shkruar nga Xhejn Ostin, është një kapitull i ëndrrave dhe shpresave që ndajnë dy motrat Benet. Xhejni dhe Elizabeta janë edhe shoqe të ngushta. Ato bien në dashuri me dy njerëz të rangut të lartë shoqëror. Xhejni bie në dashuri me zotin Bingli dhe, kur kjo gjë ndodh, Elizabeta ngazëlleshet për të. Por, fatkeqësisht, Xhejnit i thyhet zemra për

shkak të krenarisë së tepruar të zotit Darsi, mikut më të ngushtë të zotit Bingli. Darsi konstaton se Xhejni është indiferente ndaj Binglit dhe se ajo është e rangut të ulët shoqëror, kur në fakt ai vet bie në dashuri me motrën e Xhejnit, Elizabetën. Ndërkaq, kjo e fundit e paragjykon Darsin në bazë të disa informacioneve nga një zotëri i parespektuar dhe ajo fillon ta dashurojë, por edhe ta urrejë njëkohësisht. Pas shumë përjetimeve të vështira, vajzat Benet më në fund arrijnë t'i realizojnë ëndrrat e ta gjejnë lumturinë me burrat që dashurojnë. Kjo është një ndër historitë më të dashura për lexuesit.

### Struktura narrative

Në këtë roman flitet për krenarinë e tepruar të zotit Darsi dhe paragjykimet që ka Elizabeta ndaj tij. Narratori rrëfen ngjarjen në vetën e tretë. Motivi është i dashurisë, pasi motrat Benet dashurohen marrëzisht pas dy zotërinjve dhe ëndrrat e tyre do t'i realizojnë pas shumë situatave të vështira për ato dhe për familjen e tyre, megjithëse nuk përjashtohet edhe motivi social, meqë përmenden familjet e rangut të lartë dhe ato të ulëta shoqërore. Kjo vepër përmban rrëfim, përshkrim, dialog e monolog. Autori rrëfen ngjarje të ndryshme e të rëndësishme për lexuesit dhe përshkruan njerëz e vende të ndryshme. Rrëfimi herë i takon retrospektives, herë prospektives. Janë këto dy teknika, të cilat mundësojnë një tablo më të qartë të vijës fabulative. Kjo mundësohet përmes figurave të rrëfimit, si: analeksa, proleksa, metafora, metonimia, krahasimi etj. Dialogu dhe monologu shpeshherë nuk paraqesin vetëm teknikat e shkrimit, por përfaqësojnë edhe karaktere. Në romanin në fjalë, rolin e protagonistëve e kanë: Elizabeta, Xhejni, Darsi, Bingli, zoti Benet, Xhorxhiana Darsi, zoti Gardiner, zonja Gardiner, kolonel Ficuilliami, zonja Rejnolds, Sharlotë Luksi etj., përderisa përballë tyre vihen antagonistë të tipit si: zoti Uikhem, zoti Kollins, zonja Benet, Lidia Benet, Katerinë dë Bërg etj. Fillim dhe fund, koha është objektive, ndërsa ngjarja zhvillohet në hapësirën reale, siç është Anglia. Me një fjalë, kemi të bëjmë me një roman që përpiket me të gjitha nuancat t'i përngjajë jetës reale, pjesë e së cilës është edhe krenaria dhe paragjykimimi.



### Fabula dhe karakteret

Xhejni, një vajzë e dashur e me plot virtyte, takon aristoklatin e ri në Neddherfilld, zoti Binglin dhe bie në dashuri me të. Elizabeta gëzohet shumë për të motrën, por gjithçka ndryshon me ndërhyrjen e zotit Darsi, mikut të ngushtë të zotit Bingli, i cili me krenarinë e tij arrin t'i ndajë, duke gjykuar se familja Benet nuk ishte e rangut të lartë shoqëror dhe se Xhejni ishte indiferente ndaj ndjenjave të Binglit. Elizabeta e paragjykon zotin Darsi në bazë të informacioneve të Uikhemit, që në të vërtetë del një njeri i parespektuar e i keq, i cili nuk kishte vepruar mirë ndaj familjes së Darsit, duke gënjer kështu babain e Darsit, i cili ishte kujdesur për të, për të marrë para dhe duke mashtruar motrën e vogël të Darsit, në shenjë hakmarrjeje, pasi nuk ia kishte arritur qëllimit. Gjatë vizitës në Rozings, Elizabeta takon një njeri të respektuar, kolonel Ficuilliamin dhe zonjën Katerinë dë Bërg, një zonjë e pasur dhe mendjemadhe. Ndërkaq, zoti Bingli, i vënë në kurth, ndodhej larg, në Londër dhe motrat e tij i dërgonin letra Xhejnit, duke i humbur shpresat me vëllain e tyre.

Një ditë, Darsi shkon në Rozings, në shtëpinë e të neveritshmit zotit Kollins dhe gruas së vet e mikes së Elizabetës dhe Xhejnit, Sharlotës, kur Elizabeta ndodhet e vetme në shtëpi. Kështu, ai vendos se pavarësisht situatave të pakëndshme që kishte kaluar me Elizabetën dhe pas shumë muajsh, t'i shprehë dashurinë ndaj saj dhe t'i propozojë martesë. Elizabeta mbetet e habitur dhe e zemëruar e akuzon se ai nuk ishte njeri i mirë, se ai kishte fajin që Xhejni po vuante aq shumë nga ndarja me Binglin dhe për fatkeqësitë që i kishin ndodhur Uikhemit për shkakun e tij, për të cilat ky i fundit e kishte gënjyer Elizabetën. Darsi pasi i shprehë dashurinë e i propozon martesë dhe mori ato akuza nga Elizabeta, largohet dhe të nesërmen vjen dhe i jep një letër asaj, ku i sqaron gjithçka: se ai nga krenaria e kishte parë Xhejnin indiferente ndaj mikut të vet, si dhe i tregon të vërtetën mbi Uikhemin. Pas kësaj, Elizabeta fillon të dyshojë në Uikhemin dhe e kupton se ai nuk ishte njeri i mirë, siç ajo e kishte menduar, por një njeri i cili i do vetëm paratë dhe fillon ta mendojë Darsin si një njeri më të arsyeshëm, në bazë të sjelljeve të tij ndaj saj. Më pas, ajo merr lajmin e tmerrshëm se motra e saj e vogël, Lidia, e cila e kishte zakon të bënte thashetheme, ishte arratisur me Uikhemin. Por, problemi zgjidhet kur zoti Gardiner, vëllai i zonjës Benet i gjen dhe ata martohen, pasi Lidia kishte turpëruar veten dhe famljen e saj me këtë gabim që kishte bërë. Elizabeta pasi kthehet në Hansford, në vendin ku jeton, shkon për vizitë me dajën dhe teton Gardiner në Pembërli, pronë kjo e zotit Darsi. Aty takon zotin Darsi, i cili sillet shumë mirë dhe i kërkon Elizabetës të takohet me motrën e tij, Xhorxhianën. Çdo ditë e më tepër Elizabeta admiron mirësjelljet e Darsit dhe e kupton se e ka paragjykuar. Edhe Darsi e kupton se për shkak të krenarisë kishte bërë një gabim, kupton se edhe Xhejni e dashuronte shumë Binglin dhe e rregullon gabimin e bërë.

Elizabeta, më në fund pranon se është e dashuruar marrëzisht me Darsin, por nuk kishte shpresa se ai mund t'i propozonte për herë të dytë, pasi herën e parë ajo e kishte refuzuar, duke e akuzuar për dy ngjarje, të cilat tashmë kishin kaluar. Mirëpo, në fund, Xhejni martohet me burrin që dashuron, Binglin, Elizabeta martohet me Darsin, dashurinë e jetës dhe jetojnë në Pembërli. Nëna e vajzave ndihej krenare për to, meqë ajo mendonte vetëm për pasuri dhe famë, por vajzat e saj nuk mendonin në të tilla gjëra. Motrat Benet banonin afër. Elizabeta u bë shoqe e ngushtë me Xhorxhianën dhe të dy çiftet jetuan të dashuruar e të lumtur përgjithmonë!

Përfundimisht, krenaria e tepruar shpeshherë të bën të gabosh dhe të çon drejt paragjykimeve joreale, siç ka ndodhur në këtë libër, sepse në fund të fundit të gjithë jemi njerëz dhe kemi të drejtë të jetojmë si të dëshirojmë. Pra, nuk duhet të ketë ndarje në mes njerëzve.

*(Autorja ndjek leksionet në shkollën jopublike "Mileniumi i Tretë")*


## **Otello, arapi i Venedikut dhe Otello, arapi i Vlorës**

**Shkruan: Dina Hajrullahu**

“Otello, arapi i Venedikut” është tragjedi e William Shekspirit, e cila besohet se është shkruar rreth vitit 1603 dhe e bazuar në historinë e shkurtër italiane “Un Capitano Moro” (“Një kapiten arap”) nga Cinthio, e publikuar në vitin 1565. “Otello, arapi i Vlorës”, është romani i dytë i Ben Blushit, një vit pas librit të tij të parë “Të

jetosh në ishull”, i cili theu rekordet e librave shqip me mbi 20.000 kopje të shitura vetëm për dhjetë muaj.

## Analizë tekstuale



“Otello, arapi i Venedikut” e shkruar nga W. Shekspiri ka statusin e arkitekstit, ndërsa “Otello, arapi i Vlorës” e shkruar nga Shekspiri është tekst i bazuar mbi të, dhe si i tillë, ka statusin e hipertekstit, sepse motivohet nga një kryevepër. Ndërmjet këtyre dy teksteve mund të gjejmë analogji. Ngjarjet nuk janë të njëjta, por në të dyja rastet fundi është tragjik, emrat dhe karakteret e personazheve janë të njëjta, gjithashtu janë disa shenja simbolike që janë shkaktarë të fatkeqësive, si: shamia e Otellos që është e trashëguar brez pas brezi prej familjes së tij. Tema është e përgjithshme dhe motivi është social, sepse tregohet diskriminimi i njerëzve në shoqëri, sidomos atyre me ngjyrë të zezë. Në të dy veprat hapësira është reale; te vepra e Shekspirit ngjarja zhvillohet në Venedik, ndërsa te vepra e Ben Blushit, në Venedik dhe në Vlorë. Te e para mbizotëron herë-herë diskursi personal, e te i dyti diskursi personal dhe biblik (Adami, Eva, Krishti etj.). Te vepra e Ben Blushit koha është objektive; ngjarja ndodh rreth viteve 1300-1400. Gjithashtu, në këtë vepër, si te Shekspiri, përdoren disa elemente fantastike, si: lëngu i dashurisë, i cili tregon se si i përziën disa gjëra të ndryshme për të formuar lëngun magjik. Te “Otello” i Shekspirit vërejmë edhe shprehjen ‘e shoh në këmbë’, që i dedikohet Jagos, një intriganti i cili i kthen të gjithë personazhet kundër njëri-tjetrit, sepse në kohët e vjetra besonin se djalli kishte këmbë të cjamin dhe, kështu, ligësia e tij i bën shumë persona të mendojnë që ai ishte vetë djalli në formë të një njeriu. Gjithashtu, vërehen edhe disa fjali të pakuptimta, kur Marko Polo i tregon aventurat e tij gjyshes së Albano Contarinit.

## Dallimet në formë dhe strukturë

“Otello” i Shekspirit është e shkruar si dramë, për këtë arsye i gjithë teksti është në formë dialogu. Ka raste kur shfaqet monologu, kur Otello flet me Desdemonën, përderisa ajo është e vdekur dhe nuk ka mundësi që ta dëgjojë. “Otello” i Ben Blushit si formë është roman. Edhe në këtë rast ka disa dialogë mes personazheve, por shumica e tekstit është rrëfim, ku autori e bën një lojë, duke kaluar nga ai introspektiv në atë retrospektiv. Rol të rëndësishëm luan koha se kur janë shkruar këto vepra, Shekspiri ka përdorur mënyrë më të thjeshtë, e te Ben Blushi vërehen menjëherë elementet postmoderne, që pos kalimit të një kohe në kohën tjetër, kalon prej një ngjarjeje në një ngjarje tjetër (njëherë flet për jetën e Otellos, pastaj fillon të tregojë një ndodhi te familja Contarini). Meqë “Otello, arapi i Venedikut” është e shkruar si

dramë, ajo është e ndarë në akte, që gjithsej i ka pesë, ndërsa “Otello, arapi i Vlorës” është roman dhe është i ndarë në trembëdhjetë pjesë (kapituj).

## **Një personazh dhe dy vepra**

Personazhi kryesor te të dyja veprat është Otello që kuptohet qysh prej titujve. Në të dyja rastet Otello është një arap (njeri i zi) fatkeq, por me shpirt të mirë që është i dashuruar në një vajzë që quhet Desdemona. Pra, Desdemona bashkë me personazhet e tjera si Emilia, Jago dhe Kasi, përdoren në të dy veprat dhe kanë karakteret shumë të ngjashme. Prej protagonistëve (personazheve pozitive) janë Desdemona, Emilia dhe Kasi, ndërsa si antagonist (personazh negativ) e kemi Jagon. Te vepra e Ben Blushit karakteristikat e personazheve tregohen që kur ishin fëmijë. Desdemona që ishte vajza më e vogël dhe kishte dëshirë të fshihej dhe në atë mënyrë e shprehte dashurinë e saj varësisht kush dhe si e gjente. Emilia ishte motra e madhe e Desdemonës, e cila mendohej të merrte rolin e nënës, pasi që nëna e tyre kishte vdekur. Jago ishte vëllai, i cili ishte i zgjuar dhe gjente kënaqësi kur të tjerët vuanin dhe kur arrinte t’i bënte të qajë. Këtu babai i fëmijëve quhet Albano Contarini. Te Shekspiri, këta personazhe nuk janë vëllezër e motra, gjithashtu tregohet jeta e tyre kur janë më të pjekur dhe babai i Desdemonës quhet Brabant. Personazhet që ndodhen vetëm te “Otello”, arapi i Venedikut janë: Roderigu, Duka i Venedikut, Montani, Bjanka, Lodoviku dhe Gratiani. Te “Otello, arapi i Vlorës” janë: Komita Muzaka, Rugina, Balsha II, Stefan Gjika, Andrea dhe Hamiti.

## **Analogjia fabulative**

Te vepra e Shekspirit bëhet fjalë për Otellon, një arap, që martohet me Desdemonën. Atëherë, Jago me dinakërinë e vet mundohet ta shkatërrojë Otellon. Jago kishte bërë plane të ndryshme që Otello të besojë që gruaja po e tradhton me nënoficerin e tij, Kasin. Pas disa provave të rrejshme (të Jagos), Otello beson dhe kështu e vret Desdemonën nga turpi dhe inati. Atëherë gruaja e Jagos, Emilia, tregon që ato ishin vetëm gënjeshtër dhe nga pikëllimi i madh për vrasjen e padrejtë e vret veten. Te vepra e Ben Blushit “Otello, arapi i Vlorës” bëhet fjalë për Otellon, një arap, që prindërit e tij e shesin për shkak të kushteve shumë të këqija të jetesës. Gjatë një udhëtimi ai mbetet në Vlorë dhe së pari bie në duart e një doktori, i cili provon shumë eksperimente në trupin e tij. Pas vdekjes së doktorit e fusin në burg, sepse mendojnë që ai e kishte vrarë atë. Aty qëndron rreth 7 vjet, pastaj kur Vlora është e rrezikuar nga Turqia, vendosin që të burgosurit të shkojnë në luftë. Pas luftës ai kalon edhe disa vite te shtëpia e doktorit të vdekur, derisa shfrytëzon rasin që të kthehet te shtëpia e pronarit që e kishte blerë. Aty ishte vajza e tij të cilën ai e dashuronte, Desdemona, dhe pasi e sheh që nuk kishte mundësi që edhe ajo ta donte, ai ia jep një lëng magjik. Kur Desdemona e pi, ajo vdes. Vdekja e saj është e papritur dhe nga dëshpërimi i thellë që kishte vrarë vajzën që e donte, pi edhe ai pak prej lëngut dhe vdes.

## Përfundim

Duke e ditur që ka një periudhë të gjatë kohore mes realizimeve të këtyre dy shkrimeve, i dallojmë shumë lehtë elementet që përdoren te secila prej tyre. Vepra shumë të fuqishme që flasin për besim, dashuri, tradhti e diskriminim. Tregohet për besimin e tepërt ndaj një personi, që në të vërtetë, ai mund të jetë pikërisht personi që është i fshehur ndër një maskë i cili e pret kohën për të të shkatërruar gjithçka që ke.

*(Autorja ndjek leksionet në shkollën jopublike "Mileniumi i Tretë")*

## Romani "Hëna e re" një bestseller i ri

*(Botuar në gazetën "Kosova sot", 3 prill 2010)*

Stephenie Meyer : "Hëna e re", përkthyer nga Marsida Gjoncaj, "Morava", Tiranë, 2010)

**Shkruan: Genita Abazi**

### Hyrje



Libri më i ri "Hëna e re", i autores tashmë të njohur, Stephenie Meyer, vazhdim i librit të saj të parë "Muzgu", sjell aventurat e jashtëzakonshme të tetëmbëdhjetë vjeçares, Bela Suanit. Pas leximit të "Muzgut", adoleshentët mezi prisnin të lexonin vazhdimin e historisë së dashurisë së Eduard Kullenit dhe Bela Suanit. Mirëpo, për çudinë e të gjithëve, kjo dashuri nuk zgjati dhe aq shumë. Kësaj radhe, "Hëna e re", lexuesin e vë përpara aventurave të reja të Bela Suanit, duke sjell miqësi të reja, kurthe nga më të ndryshmet, frikë, me të cilat ajo ndeshet. Pas braktisjes nga Eduardi, Bela ndihet çdo ditë e më shumë e vetmuar, duke pasur nevojë për një njeri që t'i qëndrojë pranë. Kalon shumë vuajtje e sakrificë derisa ajo gjen njeriun e duhur për këtë. Mirëpo, kjo miqësi, a do të bëjë që Bela, si protagoniste kryesore, të harrojë dashurinë e saj të vërtetë?

### Struktura narrative

Në këtë vepër kemi një temë individuale, për shkak se flitet për dashurinë e Eduardit dhe Belës. Si motiv theksohet motivi social, por në të njëjtën kohë edhe ai erotik, pasi që Bela është marrëzisht e dashuruar me Eduardin. Por, kur kjo lidhje të marrë fund, Bela do të miqësohet gjithnjë e më shumë me Xhekobin dhe kjo gjë do ta ndalojë që asaj t'i kujtohet

njeriu më i çmuar se edhe vetë jeta. Narratori në këtë vepër paraqitet në dy mënyra, si narrator personazh dhe si i gjithëdijshëm. Narratori flet në vetën e parë, por s'është rrëfim autobiografik. Ngjarja zhvillohet në kohë dhe në hapësirë reale. Struktura narrative në këtë vepër përfshin rrëfimin por edhe përshkrimin. Këtu dallohen të gjitha llojet e rrëfimeve, si: rrëfimi retrospektiv, introspektiv dhe ai prospektiv. Rrëfim retrospektiv kemi të tipit: "Më kujtonte kohën kur Eduardi përvidhej përmes dritares sime natën...", tutje rrëfimi introspektiv shtrohet si në këtë fjali: "Ai zgjati dorën e tij në kërkim të sime", ndërsa rrëfimi prospektiv, shoqërohet me një proleksë interesante që paralajmëron ndodhinë si në fjalinë: "Djali do të kthehej në shtëpi dhe kur kjo të ndodhte, ai nuk do të shpëtonte pa folur me mua". Gjuha e autorit është konotative, e figurshme pra, dhe këtë e realizon përmes figurave stilistike, si: metafora, metonimia, krahasimi, hiperbola etj., por me dominim të metonimisë. Diskursi herë-herë është mitik e herë-herë fantastik. Një roman, në të cilin shkrimi nganjëherë shfaqet si romancë, e nganjëherë si një film triller, e që e mban lexuesin pezull.

### Gjetjet fabulative

Në këtë vepër bëhet fjalë për Izabela Suanin, kryesisht për jetën dhe aventurat e saj. Në "Hëna e re" ajo feston ditëlindjen e saj të tetëmbëdhjetë me dashurinë e jetës së saj në krah, Eduardin. Ditëlindja e saj festohet në shtëpinë e Kullenëve, më konkretisht në shtëpinë e familjes së Eduardit. Mirëpo, dita më e lumtur e jetës së saj, kthehet në një tmerr të vërtetë kur Xhespëri, vëllai i Eduardit, që nuk është mësuar akoma t'i rezistojë etjes për gjakun e njerëzve, synon ta sulmojë Belën. Por, fatmirësisht pjesa tjetër e familjes, që tashmë ishin mësuar me gjakun e tyre, arrijnë ta mbrojnë atë. Eduardi, duke menduar për të mirën e saj, merr vendim që ta braktisë. Përshëndetet me të dhe largohet përgjithmonë. Bela, e vetmuar, e lodhur pas gjithë kësaj periudhe, ndien nevojën për dikë që t'i qëndrojë pranë. Mirëpo, ishte e kotë. Ai ishte larguar dhe bashkë me të kishte marrë gjithçka me vete, zemrën, ndjenjat, kujtimet, gjithçka që e lidhte me të. Ajo gjithnjë e më shumë ndiente zbrazëtirën që i gërryente shpirtin. Sa herë që ajo prekte kraharorin, e ndiente se ishte bosh. Pas shumë vuajtjeve që përjetoj, në ditët e saj më të vështira iu gjend Xhekobi, që tashmë ishte shoku i saj më i mirë dhe i cili po plotësonte atë zbrazëtirë që ajo ndiente në kraharor.

Bela, gjithnjë e më shumë po miqësohej me Xhekobin dhe kjo gjë ia ndalonte asaj të kujtonte imazhin e Eduardit. Mirëpo, ndodhi që një ditë, kur asaj iu kishte ngulitur në kokë mësimi i ngasjes së motoçikletës, gjë që babai i saj ia kishte ndaluar, ajo dëgjoji zërin e tij. Atë zë të mrekullueshëm e të pazëvendësueshëm, atë zë të munguar prej kohësh. Pas asaj çmendurie, ajo zbuloi që vetëm kur të bënte marrëzira, do të mund të dëgjonte zërin e tij të çmuar. Ajo kishte të drejtë. E dëgjonte gjithmonë, kurdoherë kur i kanosej rreziku dhe në ato raste, zëri i tij shfaqej si zë paralajmërues. Nuk kaloi shumë kohë, kur ajo arrinte ta shihte edhe imazhin e tij. Të paktën, këto i mjaftonin që ajo pak dashuri që ndiente për të, të mos shuhej. Por, më vonë, asaj iu desh të përballej me një sfidë tjetër, duke zbuluar që Xhekobi, miku i saj më i mirë, të cilit i besonte për çdo gjë, ishte njeri-ujk, armik i përjetshëm i gjakpirësve. Edhe ai, në mënyrë që ta mbrojë, e braktisë. Bela, tashmë e rraskapitur nga braktisjet, nga jeta e saj, nga çdo gjë që e rrethonte, bie nga një shkëmb i lartë e hidhet në det. Për fat të mirë, Xhekobi arrin ta shpëtojë. Eduardi keqkupton situatën, duke menduar që Bela ka vdekur dhe dëshiron që edhe ai të vdesë. Dëshirë kjo, e cila synon të realizohet në mënyrën më të keqe të mundshme: duke dalë në diell dhe duke zbuluar lëkurën e tij përpara të gjithë njerëzve që shndrit sikur të ishte e mbuluar me një milion diamante. Bela, bashkë me Lizën, motrën e

Eduardit, arrin ta shpëtojë atë. Më pas, ai ia bën të kuptojë që nuk ka dashur kurrë ta lëndojë, përkundrazi, ka dashur vetëm ta mbrojë. Në fund, Bela detyrohet të zgjedhë midis miqësisë me Xhekobin dhe dashurisë së Eduardit. Pa dyshim që zgjodhi Eduardin, e kush nuk do ta donte? E kishte shumë të vështirë të ndahej nga Xhekobi, sepse ishte i vetmi që i pati qëndruar pranë kur ishte fare e vetme. Mirëpo, ajo zgjodhi dashurinë ashtu siç të gjithë do të kishim vepruar...

## **Dallimet dhe ngjashmëritë mes librit dhe filmit**

Duke pasur parasysh që libri zë diku rreth 500 faqe, themi se ka më shumë hapësirë për të shtjelluar ngjarjen në libër sesa në film. Ja pse të gjithë lexuesit e librit ankohen se përse disa pjesë të librit, apo të ndryshme nga ai, nuk janë përfshirë në film. Pjesët të cilat nuk janë paraqitur fare në film apo edhe ndryshe nga ato janë: pjesa gjatë hulumtimit të gjurmëve të Viktorias, kur ajo, në film vrau Billin, ndërsa në libër, ajo vrau Herrin, shokun e ngushtë të Billit. Pastaj, në pjesën e fundit të filmit, Eduardi i kërkon dorën Belës për martesë, ndërsa në libër, ai i kërkon dorën asaj pas rikthimit të tyre së bashku. Një tjetër pjesë që nuk u paraqit fare në film, ishte blerja e motoçikletës nga ana e Belës.

-Duke ditur po ashtu, që filmi është bazuar në libër, themi se ka ngjashmëri të shumta si: festimi i ditëlindjes së Belës, ikja e Eduardit, shoqëria e Xhekobit me Belën, vegimet e saj për Eduardin, dëshira për vdekjen e tij, shpëtimi i tij nga ana e Belës etj...

## **Përmbyllje**

Libri "Hëna e re" na udhëzon drejt së ardhmes, duke na ndihmuar rreth zgjidhjes së problemeve tona. Ky libër na sjell një mesazh, duke na thënë të mos dorëzohemi, të ecim përpara e të luftojmë me ata që na ndalojnë këtë, sepse në fund të fundit, gjithçka do të rregullohet dhe e gjitha do të mbarojë.

*(Autorja ndjek leksionet në shkollën jopublike "Mileniumi i Tretë")*